




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.520 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z.Goran Milenković- Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “NTP “Vlora” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Europrinty” shpk - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Prishtinë, më datën: 26.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht sie bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NTP “Vlora” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues OE “NTP “Vlora” - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazua, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI.Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 05. 03. 2019.

Njoftimi për indokues – përmirësim i gabimit është bërë me dt: 11.03.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 02.04.2019.

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 02.04.2019.

Data e përfundimit të ri vlerësimit të ofertave është bërë me dt: 26.07.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm është bërë me dt: 29.07.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 02.08.2019.

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 06.08.2019.

Operatori ekonomik ankues OE “NTP “Vlora” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.08.2019 me nr. 520/ 19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr. të prokurimit: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 66.1, 69, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 26.8 pika k, 29.8 pika 1, 39, dhe 40 të UOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.08.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:30.08.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kornizë – 12 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave ku përsëri është propozuar për dhënie OE “Europrinty” shpk - Prishtinë.

Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës më datën 02.08.2019, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore të paraqitura si në ankesën e deponuar në OSHP. AK–Komuna Prishtinë më datën 07.08.2019, nxjerr vendim dhe refuzon të njëjtën kërkesë si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore (neni 113):

Pretendimet kryesore ankimore përsëri kanë të bëjnë kundrejt operatorit ekonomik të ri propozuar për dhënie të kontratës, rrjedhimisht janë të njëjta me ato të ankesës paraprake ku ne i kemi trajtuar dhe kemi dhënë propozimin tonë. Paneli shqyrtues ka nxjerr vendim më datën 20.06.2019, ku përmes arsyetimit të njëjtit vendim, përveç tjerash është kërkuar nga AK, që gjatë rivlerësimit të ofertave konform nenit 59.2 dhe 72, të LPP-së, ti verifikoj dhe të kërkoj sqarime shtesë për të gjitha dokumentet dhe referencat e operatorit ekonomik të ri rekomanduar për kontratë.

- Autoriteti Kontraktues/ Komuna Prishtinë, përgjatë procesit të rivlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës. Sqarimet e ofruara i kemi kërkuar nga AK, përmes emailit të datës 26.08.2019, por deri më datën e protokollimit të këtij raporti nuk i kemi pranuar.

Parashtruesi i ankesës edhe tani insiston që katër (4) projektet e përshkruara si të realizuara si dhe faturat e prezantuara janë fiktive, madje pretendohet edhe për nënshkrime të falsifikuara. AK/ Komuna Prishtinë, përmes arsyetimit të vendimit të kërkesës për rishqyrtim përsëri potencon se vërtetësia e shkresave nuk është në kompetencë të AK-së.

Sipas kopjeve të faturave, referencave dhe kontratave të prezantuara në ofertë nga operatori ekonomik i ri propozuar për dhënie të kontratës, po sqarojmë në mënyrë edhe më të zgjeruar, se të njëjtat shkresa kanë kontradikta në mes vete, përkatësisht ekzistojnë fatura me numër të njëjtë, faturat e prezantuara nuk janë të pranura nga AK-të përkatës, përmbajnë data të largëta pas përmbylljes së kontratave etj.

Kërkesa e pikës 9.1, të FDT-s, ka qenë e qartë, është kërkuar: “OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme (gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit

të njoftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€". Dëshmia dokumentare: "Një liste të kontratave të realizuara, duke plotësuar aneksin 6, të DT, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjitën referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve".

Parashtruesi i ankesës përsëri konteston test raportet e prezantuara në ofertë. Është e vërtetë se të njëjtat test raporte, nuk kanë validitet megjithatë, AK përmes dosjes së tenderit apo njoftimit për kontratë nuk ka kërkuar ndonjë test raport. Tek disa nga pozicionet e paramasës përveç kërkesës për produkt, është përshkruar edhe standardi i produktit që duhet të ofrohet, megjithatë përshkrimi i njëjtë nuk është kërkesë e kualifikimit të operatorit ekonomik.

Përfundimisht, në mbështetje të asaj që u përshkrua më lartë ne ri propozojmë rivlerësim të ofertave me qëllim të aplikimit të drejtë të dispozitave të LPP-së, dhe rekomandimeve të dala me vendimin e PSH-së, me nr.259/19, të datës 04.07.2019. Përkatësisht AK, të verifikoj nëse OE, i propozuar për dhënie të kontratës, e përmbush vlerën dhe kërkesën e pikës 9.1& 9.2, të FDT-së.

Verifikimi mund të bëhet:

- Përmes librit të shitjes se OE, të propozuar për dhënie të kontratës;
- Përmes transaksioneve bankare;
- Përmes, sqarimit të dhënë nga kontraktoret (AK-të / Blerësi), sipas projekteve të prezantuara në ofertë, tej.

Shkeljet e konstatuara të LPP-s

Neni 59, LPP – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE NTP "Vlora" – Prishtinë, të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet propozimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Operatori ekonomik "NTP "Vlora" - Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 02.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 02.09.2019, ka njoftuar, Autoriteti Kontraktues, lidhur me mendimin e ekspertit edhe pse shkresat i ka pranuar me kohë i njëjti nuk është përgjigjur.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 26.09.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit të ofertave ku përsëri është propozuar për dhënie OE “Europrinty” shpk - Prishtinë.

Paneli shqyrtues sqaron se pretendimet kryesore ankimore përsëri kanë të bëjnë kundrejt operatorit ekonomik të ri propozuar për dhënie të kontratës, ku pretendimet janë të njëjta me ato të ankesës paraprake ku i kemi trajtuar dhe kemi dhënë propozimin tonë. Paneli shqyrtues ka nxjerr vendim më datën 20.06.2019, ku përmes arsyetimit të njëjtit vendim, përveç tjerash është kërkuar nga AK, që gjatë rivlerësimit të ofertave konform nenit 59.2 dhe 72, të LPP-së, ti verifikoj dhe të kërkoj sqarime shtesë për të gjitha dokumentet dhe referencat e operatorit ekonomik të ri rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues/ Komuna Prishtinë, përgjatë procesit të rivlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës. Sqarimet e ofruara i kemi kërkuar nga AK, përmes emailit të datës 26.08.2019, por sqarimet nuk i kemi pranuar. Andaj konstatojmë se autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar që dëshmitë e kërkuara të dorëzohen në të kundërtën do të konsiderohet se ato dëshmi nuk ekzistojnë sepse nuk ka pasur mundësi të shihen nga eksperti apo edhe nga paneli shqyrtues.

Lidhur me pretendimin e ankuesit ku ai insiston që katër (4) projektet e përshkruara si të realizuara si dhe faturat e prezantuara janë fiktive, madje pretendohet edhe për nënshkrime të falsifikuara. AK/ Komuna

Prishtinë, përmes arsyetimit të vendimit të kërkesës për rishqyrtim përsëri potencon se vërtetësia e shkresave nuk është në kompetencë të AK-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se sipas kopjeve të faturave, referencave dhe kontratave të prezantuara në ofertë nga operatori ekonomik i ri propozuar për dhënie të kontratës, po sqarojmë në mënyrë edhe më të zgjeruar, se të njëjtat shkresa kanë kontradikta në mes vete, përkatësisht ekzistojnë fatura me numër të njëjtë, faturat e prezantuara nuk janë të pranuar nga AK-të përkatës, përmbajnë data të largëta pas përmbylljes së kontratave etj. Kërkesa e pikës 9.1, të FDT-s, ka qenë e qartë, është kërkuar: “OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€”. Dëshmia dokumentare: “Një liste të kontratave të realizuara, duke plotësuar aneksin 6, të DT, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjitën referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve”. Andaj paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK është i obliguar që ti sqaroj dëshmitë e cekura si me lart, nëse këto dëshmi nuk sqarohen nga ana e AK-së dhe të argumentohen para OSHP-se do të konsiderohet se OE në fjalë nuk ka plotësuar kërkesën e AK-se të cekur si me lart. Po ashtu paneli shqyrtues konstaton se lidhur me arsyetimin e AK-së se nuk është në kompetencë të AK-së, paneli shqyrtues konstaton se nëse në autoritetin kontraktues lidhur me një aktivitet të prokurimit ndonjë OE pjesëmarrës ngrit dyshimin lidhur me ndonjë dokument të falsifikuar për ndonjërin nga ofertuesit pjesëmarrës sigurisht që AK ka autorizim që ta verifikoj atë pretendim dhe nëse e vërteton atë fakt atëherë mund të parashtroj kërkesë në OSHP që ndaj atij OE të ndërmerren masa në pajtësi me nenin 99 të LPP-së.

Lidhur me pretendimet e ankuesit i cili përsëri i konteston test raportet e prezantuara në ofertë. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se është e vërtetë se të njëjtat test raporte, nuk kanë validitet megjithatë, AK përmes dosjes së tenderit apo njoftimit për kontratë nuk ka kërkuar ndonjë test raport. Tek disa nga pozicionet e paramasës përveç kërkesës për produkt, është përshkruar edhe standardi i produktit që duhet të ofrohet, megjithatë përshkrimi i njëjtë nuk është kërkesë e kualifikimit të operatorit ekonomik.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në rivlerësim të ofertave me qëllim të aplikimit të drejtë të dispozitave të LPP-së, dhe konstatimeve të dala me vendimin e PSH-së, me nr. 259/19, të datës 04.07.2019, AK, të verifikoj nëse OE, i propozuar për dhënie të kontratës, e përmbush vlerën dhe kërkesën e pikës 9.1 & 9.2, të FDT-së.

Verifikimi mund të bëhet:

- Përmes librit të shitjes së OE, të propozuar për dhënie të kontratës;
- Përmes transaksioneve bankare;
- Përmes, sqarimit të dhënë nga kontraktohet (AK-të / Blerësi), sipas projekteve të prezantuara në ofertë, apo cilëndo dëshmi të ligjshme sipas LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së . Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK.Komuna Prishtinë.

1x1 OE-"NTP "Vlora" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.